

CURRICULUM VITAE

Ambera Duka, MA, ka përfunduar studimet e larta në vitin 1989 në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan, në degën Cikël i Ulët, me rezultate shumë të mira.

Studimet pasuniversitare master, i përfundon në vitin 2008, pranë Universitetit të Tiranës, në Fakultetin e Shkencave Sociale me drejtim Pedagogji. Aktualisht ndjek shkollën e doktoraturës në Universitetin e Tiranës, pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, në fushën e Edukimit.

Kontributin 20-vjecar në fushën e mësimdhënies e ka dhënë në disa shkolla të qytetit të Durrësit, si psh: “Kushtrimi i Lirisë”, “Benardina Qerraxhia”, në kolegjin turk “Turgut Ozal”.

Në vitin 2007 ka punuar si lektore Part-Time në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, në Fakultetin e Edukimit. Që nga viti 2008, është lektore Full-Time në lëndët: Pedagogji e Didaktikë, pranë Fakultetit të Edukimit në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës. Aktualisht mban pozicionin e Zv. Dekanes në Fakultetin e Edukimit.

Është lektore jo efektive e lëndëve të Pedagogjisë dhe Didaktikës në Universitetin jo-publik “Vitrina” Tiranë.

Për ti ardhur në ndihmë studentëve dhe mësuesve mbi problemin e aftësisë së kufizuar, në mars të vitit 2010, boton librin “Probleme të punës mësimore me fëmijët me nevoja të vecanta”, në shqip dhe në anglisht.

Merr pjesë aktive në Konferenca Shkencore brenda dhe jashtë vendit.